



# FLETORJA ZYRTARE

E

## REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

BOTIM I KUVËNDIT POPULLOR

NOVEMBER

Nr.15

1994

Nëntor

### PËRMBAJTJA

Faqe

Ligj nr.7856 datë 21.9.1994	Për ratifikimin e "Traktatit të mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe fqinjësisë së mirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë".	683
Ligj nr.7857 datë 21.9.1994	Për ratifikimin e "Konventës ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për eliminimin e tatimeve të dyfishta..."	683
Ligj nr.7858 datë 21.9.1994	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë për shmangien e tatimeve të dyfishta..."	684
Ligj nr.7859 datë 28.9.1994	Për miratimin e dekretit nr.915, datë 5.9.1994.....	685
Ligj nr.7860 datë 28.9.1994	Për një ndryshim në ligjin nr.7805, datë 16.3.1994 "Për tatimin mbi pasurinë në Republikën e Shqipërisë".....	685
Ligj nr.7861 datë 28.9.1994	Për miratimin e dekretit nr.913, datë 25.8.1994.....	686

Ligj nr.7862 datë 28.9.1994	Për miratimin e dekretit nr.919, datë 16.9.1994.....	687
Ligj nr.7863 datë 28.9.1994	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve"	687
Ligj nr.7864. datë 29.9.1994	Për Kryqin e Kuq Shqiptar.....	688
Ligj nr.7865 datë 29.9.1994	FOR THE PROTECTION OF THE EMBLEM AND THE NAME OF R Për mbrojtjen e emblemës dhe të emrit të Kryqit të Kuq.....	690
Ligj nr.7867 datë 12.10.1994	Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme....	692
Ligj nr.7868 datë 12.10.1994	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7619, datë 12.10.1992 "Për inspektoratin e kontrollit të përdorimit të energjisë elektrike".....	698
Ligj nr.7869 datë 12.10.1994	Për disa ndryshime në ligjin nr.7804, datë 10.3.1994 "Për dhomat e tregtisë dhe të industrisë".....	699
Ligj nr.7870 datë 13.10.1994	Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.....	700
	Vendim nr.6 i Gjykatës Kushtetuese.....	712
	Rregullore për dhënien e licensave për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë.....	718

## L I G J

Nr.7865, datë 29.9.1994

### PËR MBROJTJEN E EMBLEMËS DHE TË EMRIT TË KRYQIT TË KUQ

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

#### KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Duke marrë në konsideratë konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 në lidhje me përmirësimin e fatit të të plagosurve dhe të sëmurëve në forcat e armatosura në fushën e betejës (Konventa I), për përmirësimin e fatit të të plagosurve, të sëmurëve dhe të anijembyturve në forcat e armatosura në det (Konventa II), trajtimin e robërve të luftës (Konventa III), në mbrojtje të personave civilë në kohë lufte (Konventa IV), të mëposhtëquajtura konventa, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë më 27 maj 1957, si dhe duke marrë në konsideratë protokollet shtesë të 10 qershorit 1977 në lidhje me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura (Protokolli I) dhe mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jondërkombëtare (Protokolli II), të mëposhtëquajtura protokolle, në të cilat Shqipëria ka aderuar më 16 qershor 1993,

#### V E N D O S I :

##### Neni 1

Emblema e Kryqit të Kuq formohet nga katër krahë me gjatësi të njëjtë dhe ngjyrë të kuqe mbi një sfond të bardhë.

##### Neni 2

Emblema e Kryqit të Kuq përdoret si shenjë treguese dhe shenjë mbrojtëse në përputhje me konventat e Gjenevës, protokollet shtesë dhe me këtë ligj.

##### Neni 3

Kryqi i Kuq Shqiptar përdor në çdo kohë emblemen dhe emrin e Kryqit të Kuq për veprimtaritë e tij në përputhje me parimet themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe, si dhe të legjislacionit të vendit.

##### Neni 4

Organizmat ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe personeli i tyre i njohur me ligjet ndërkombëtare, janë të autorizuar të përdorin në çdo kohë emblemen dhe emrin e Kryqit të Kuq.

#### Neni 5

Në raste të veçanta dhe me autorizimin e Kryqit të Kuq Shqiptar, në kohë paqeje, mund të përdoret emblema e Kryqit të Kuq për të shënuar mjetet e përdorura si ambulancë, si dhe për të shënuar vendet e ndihmës së parë, të cilat u rezervohen falas dhe në mënyrë të paanshme të plagosurve e të sëmurëve.

#### Neni 6

Me autorizimin e Këshillit të Ministrave ose të organeve e institucioneve të vendosura prej tij, emblema e Kryqit të Kuq mund të përdoret për të shënuar në kohë lufte personelin dhe materialet e mbrojtura nga konventa e Gjenevës dhe protokollet shtesë, që janë:

- 1) ndërtesat, instalimet, materiali sanitar, mjetet e transportit dhe personeli i shërbimit shëndetësor të ushtrisë;
- 2) përfaqësuesit e feve;
- 3) zonat dhe lokalitetet shëndetësore, të sigurimit dhe zonat neutrale;
- 4) spitalet civile dhe personeli i tyre;
- 5) njësitë sanitare, mjetet e transportit dhe personeli civil i tyre;
- 6) shoqatat kombëtare të Kryqit të Kuq, shoqata të tjera kombëtare të ndihmës vullnetare, personeli dhe materialet e tyre të shërbimit sanitar.

#### Neni 7

Përdorimi i emblemës dhe i emrit të Kryqit të Kuq nga persona fizikë e juridikë në kundërshtim me mënyrën e përcaktuar në këtë ligj, cilido që të jetë qëllimi, është kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 1000 deri 10000 lekë.

#### Neni 8

Në rastet e parashikuara në nenin 7, punonjësit e Kryqit të Kuq shqiptar mbajnë procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes administrative dhe ia dërgojnë për gjykim seksionit të shëndetësisë sipas ligjit "Mbi kundërvajtjet administrative".

#### Neni 9

Neni 4, 7 dhe 8 të këtij ligji janë të zbatueshme edhe për emblemën e Gjysmëhënës së Kuqe mbi një sfond të bardhë dhe për emrin e Gjysmëhënës së Kuqe.

#### Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 946, datë 17.10.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Sali Berisha